

AKT - THEMELIMI

“GLAB - LAW & BUSINESS” SH.P.K. Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (sh.p.k.)

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Forma, Selia, Kohëzgjatja

Neni 1

Themelimi, Themeluesit, Emri

Sot më datë 21.08.2023 themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin “GLAB - Law & Business” sh.p.k.

Themeluesit e shoqërisë “GLAB - Law & Business” sh.p.k., janë:

- **Z. Lorenc Baro**, atësia Flamur, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të letërnjoftimit me numër personal identifikimi H80414078D i datëlindjes 14.04.1978, banues në Tiranë - **Znj. Blerina Seseri**, atësia Riza, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të letërnjoftimit me numër personal identifikimi I25610073A e datëlindjes 10.06.1982, banuese në Tiranë.

Neni 2

Objekti i Shoqërisë

Avokati, shërbime dhe konsulencë ligjore.

Shërbime Kontabiliteti. Shërbime, konsulencë financiare dhe fiskale.

Përkthyes i certifikuar i gjuhës Italiane.

Ndërmjetësues të pasurive të paluajtshme.

Shërbime në sigurime.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

Neni 4

Selia

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën:

- Rruga “Ndre Mjeda”, Kompleksi Rezidencial “Magnet”, Struktura DA-8, Kati 0, Tiranë.

Kreu II

Kapitali i Shoqërisë

Neni 5

Vlera dhe pagesa e kapitalit të paguar

Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 10,000 (dhjetë mijë) Lekë, dhe është i ndarë në dy kuota.

1

Akti i themelimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
“GLAB - Law & Business” sh.p.k.

- Ortaku themelues **Lorenc Baro**, është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 4,900 (katër mijë e nëntëqind) Lekë, që përben 49 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Ortaku themelues **Blerina Seseri**, është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 5,100 (pesë mijë e njëqind) Lekë, që përben 51 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kreu III

Administratori i shoqërisë

Neni 6

Emërimi dhe kohëzgjatja e Administratorit

Asambleja e përgjithshme zgjedh një ose më shumë persona fizikë si administrator të shoqërisë për një periudhë 5 (pesë) vjecare, në pajtim me parashikimet e ligjit 9901 dt.14.04.2008, i ndryshuar. Emërtimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicë të zakonshme nga Asambleja e Përgjithshme.

Administratori i parë i shoqërisë për një periudhë 5 (pesë) vjecare do të jetë z. *Lorenc Baro*, atësia Flamur, shtetas shqiptar, identifikuar me anë të letërnjoftimit me numër personal identifikimi H80414078D i datëlindjes 14.04.1978, banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Kreu IV

Dispozitat Përfundimtare

Neni 7

Marrëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit që lidhet midis palëve në mbështetje të Kodit të Punës si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Ortakët e shoqërisë nuk kufizohen në rritjen e kapitalit të shoqërisë.

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë private midis ortakëve, punonjësve dhe personave të tretë, kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, mbetet në kompetencë të Gjykatës së Tiranës.

Shoqëria do të ketë vulën e saj ku do të jetë përcaktuar dhe emërtimi tregtar.

Modalitetet për ndryshimin dhe kompetencat e administratorit, kompetencat dhe marrja e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar, etj, do të rregullohen nga Statuti i Shoqërisë dhe Ligji 9901 dt.14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar si dhe Ligji 9723 dt.03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", i ndryshuar.

Tiranë më 21.08.2023

THEMELUESIT

Lorenc BARO

Blerina SESERI